



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:228891
Datë: 20.02.2025
Numri i dokumentit: 06875500

C.nr.4802/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.V. me numër personal me vendbanim në Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson L.K.G. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimi mbi bazën e pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendeve dhe pushimeve, jashtë seancës gjyqësore, me datë 20.02.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejueshme padia C.nr.4802/2024 e datës 20.08.2024, parashtruar nga paditësi B.V. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendeve dhe pushimeve.

A r s y e t i m

Paditësi B.V. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson L.K.G. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimi mbi bazën e pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendeve dhe pushimeve.

Me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.4802/2024 i datës 23.01.2025, gjykata ka ftuar paditësin, përkatësisht të autorizuarin e tij që brenda afatit prej 3 (tre) ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi të përcaktoj në mënyrë të qartë dhe konkrete kërkesëpadinë, përkatësisht të përcaktoj saktë dhe konkretisht vlerën e kompensimit lidhur me pagën shtesë për ditët e punës gjatë vikendeve dhe rrezikshmërisë, me paralajmërimin e pasojave që nëse nuk vepron sipas detyrimit dhe afatit të përcaktuar në pikën nën I. të aktvendimit C.nr.4802/2024 i datës 23.01.2025, padia do të konsiderohet e tërhequr, ndërsa në qoftë se padia do kthehej pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, do të hedhet poshtë.

Me parashtresën e datës 31.01.2025, i autorizuari i paditësit ka deklaruar se lidhur me këtë çështje juridike nuk mund ta bëjë precizimin dhe saktësimin e kërkesëpadisë dhe nuk mund ta përcaktojë periudhën kohore lidhur me kompensimin e pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendeve dhe pushimeve. Po ashtu, përmes kësaj parashtrese ka deklaruar se në padi kanë propozuar ekspertizë financiare me qëllim të vërtetimit të lartësisë së kërkesëpadisë dhe se një propozim të tillë do ta paraqesin pas pranimit të përgjigjes në padi dhe gjatë seancës përgatitore. Andaj, nga këto arsye nuk mund ta përcaktojë lartësinë e kërkesëpadisë dhe periudhën kohore për të cilën kërkohet kompensimi i kërkesave sipas kërkesëpadisë.

Në këtë drejtim, gjykata ka ardhur në përfundim se padia e paditësit duhet të hedhet poshtë, në përputhje me nenin 102 par. 3 të LPK-së lidhur me nenin 253 par. 1 pika a) dhe f) dhe 99 par. 2 të LPK-së, pasi që paditësi nuk ka vepruar sipas aktvendimit C.nr.4802/2024 i datës 23.01.2025, përkatësisht nuk ka vepruar sipas detyrimeve të specifikuara në këtë aktvendim.

Më konkretisht, në nenin 253 par. 1 pika a) të LPK-së, shprehimisht përcaktohet që “padia duhet të përmbajë kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore dhe të dhënat e tjera që duhet t’i ketë çdo parashtresë (neni 99 i këtij ligji)”. Pastaj, sipas nenit 99 par. 2 të LPK-së, shprehimisht përcaktohet që “parashtresat duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin sipas tyre. Ato duhet të përmbajnë sidomos: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin (emërtimin e personit juridik), vendbanimin apo vendqëndrimin (selinë e personit juridik) e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor apo me prokurë, po që se i kanë, objektin e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe firmën e parashtruesit”.

Së këndejmi, gjykata vlerëson se kërkesa e palës paditëse duhet të ketë një përmbajtje të caktuar dhe konkrete, në aspektin e periudhës konkrete për të cilën kërkohet një e drejtë dhe shumës përkatëse të kësaj të drejte. Pra, në bazë të dispozitës ligjore të theksuar më lartë, gjykata vlerëson se kërkesëpadija e paditësit duhet të jetë në mënyrë konkrete e caktuar dhe precizuar saktë, në mënyrë që gjykata të mund të procedojë sipas padisë. Gjithashtu, gjykata vlerëson se pala paditëse ka pasur mundësi që me rastin e parashtrimit të padisë të përcaktojë periudhën kohore të kompensimit të kërkesave të theksuara në padi dhe shumën e këtyre kërkesave, pa pasur nevojë që të kërkohen prova shtesë të theksuara në parashtresën e datës 31.01.2025. Po ashtu, gjykata e gjeti të pabazuar pretendimin e palës paditëse që gjykata t’i drejtohet të paditurës në përputhje me nenin 332 dhe 333 të LPK-së, në mënyrë që të siguroj provat. Kështu, pala paditëse me asnjë veprim apo provë nuk e ka bërë të besueshëm faktin se i është drejtuar organit shtetëror (në këtë rast të paditurës), dhe që ky organ të mos ia ketë siguruar dokumentin apo provën përkatëse, e që më pas gjykata do të vepronte sipas detyrës zyrtare për sigurimin e ndonjë prove apo dokumenti. Andaj, gjykata gjen se kërkesëpadija e caktuar dhe precizuar është kusht i domosdoshëm i padisë dhe në rast të mospërmbushjes së këtij kushti, padia duhet të hedhet poshtë.

Në vazhdim, në nenin 102 par. 3 të LPK-së thuhet që “do të konsiderohet se është tërhequr parashtresa po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhet

poshtë". Në anën tjetër, me aktvendimin C.nr.4802/2024 e datës 23.01.2025, pala paditëse në mënyrë të qartë, konkrete dhe specifike është udhëzuar për plotësimet dhe korrigjimet të cilat duhet të bëhen në padinë C.nr.4802/2024 e datës 20.08.2024, mirëpo e njëjta përmes parashtresës të datës 31.01.2025, gjykatës padinë ia ka kthyer pa e plotësuar apo korrigjuar sipas detyrimeve dhe kërkesave të aktvendimit në fjalë.

Në këtë drejtim, gjykata vë në dukje faktin se është pikërisht pala paditëse që duhet të caktoj e precizoj kërkesën e saj në kuadër të padisë, të cilën gjë pala paditëse ka dështuar ta bëjë.

Andaj, pasi që në përputhje me nenin 171 par. 1 të LPK-së gjykata është e lidhur me aktvendimet e saj, vendosi që padia e paditësit të hedhet poshtë.

Nga se u tha më lartë, konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 99 par. 2, 102 par. 3, 253 par. 1 dhe 387 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.4802/2024, datë 20.02.2025

G j y q t a r i

Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate Themelore.